

Fëmijët (që nuk kanë arritur moshën e pubertetit) nuk janë të obliguar të agjërojnë. Mirëpo, prindërit e tyre ose kujdestarët janë fuqishëm të rekomanduar për ti inkurajuar ata për të agjëruar disa ditë sepse ata do të mësohen nga kjo dhe rriten me njohjen e adhurimit të agjërit sikur që duhet të dinë edhe për faljen.

Në këtë aspekt kjo ishte praktikë e gruas së parë në Islam Rabija bint Muavije e cila transmeton që:

“Pejgamberi i Allahut paqja e Allahu goftë mbi të e dërgoi një njeri në mëngjez në ditën e Ashuras, tek shtëpitë e Ensarëve duke thënë:”Kushdo që ka kaluar mëngjezin duke agjëruar le ta kompletojë agjërimin e tij.’ Kushdo që nuk ka kaluar këtë mëngjez duke agjëruar duhet agjëruar në mënyrë vullnetare pjesën e mbetur të ditës.’ Ne agjëruam pas njoftimit, sikur që e bën edhe fëmijët tanë. Ne shkonim në Xhami dhe u krijonim lodra nga pambuku që ata të loznin me to. Nëse ndonjëri nga ta fillonte të qante për shkak të urisë, ne i jepnim atyre këto lodra për të lozur derisa arrihej koha për të ngrënë.” (Buhariu dhe Muslimi)

Të ndëruar Vëllezër dhe Motra, kujtoni që njëri nga shtatë personat që Allahu do ti fusë nën hijen e Tij ditën e Gjykimit do të jetë edhe i riu që është rritur me adhurimin ndaj Allahut.

Kështu që le të jetë fëmija juaj njëri prej tyre.

Janë shumë mënyra për ti edukuar fëmijet tuaj reth Ramazanit. Mënyra më e mirë dhe më e rëndësishmja është për të sjellë shembuj të mirë të agjërit të duhur dhe sjelljeve sipas mësimave të Pejgamberëve. Kjo është ajo që fëmijët tuaj duhet të mësojnë së pari.

Kur ju jeni duke përmbushur këto, ju mund shumë lehtë ti mësoni ata qka ju dëshironi, dhe ata do të pranojnë ato dhe do ti praktikojnë shumë lehtë ato gjithashtu. Këtu po sjellim disa lloje që ju mund ti përdorni më fëmijët tuaj. Nuk ka arsye që ju mos të mendoni edhe për të tjera:

- Varësisht në mosha e tyre inkurajoni ata që të agjërojnë disa nga ditët apo ditët tjera në tërësi, ose më shumë për ata që janë afër moshës së pubertetit. Për ata që janë akoma të rinjë mundësoni atyre që të agjërojnë një apo dy ditë dhe shpërbleni ata në prezencë të shokëve dhe miqëve për të arriturat e tyre.
- Lejoni fëmijën tuaj të shkojë së bashku me babanë e tij në Xhami për namazin e Akshamit dhe prishjen e agjërit së bashku me komunitetin e Muslimanëve, me qëllim që ata të ndiejnë madhështinë e agjërit dhe unitetit të Muslimanëve në adhurimin e Allahut.
- Nëse fëmija juaj nuk mund të agjërojë mundësoni atyre të ushqehen së bashku me juve gjatë kohës së iftarit dhe mësoni ata që ju jeni duke e prishur agjërimin edhe nëse ata kanë ngrënë më herët.
- Mësoni fëmijëve tuaj lutjet e prishjes së agjërit .
- Merrni fëmijët tuaj në namazin e teravisë në mënyrë që ata të mësohen me taravitë që nga mosha e re. Ata mund të qëndrojnë ulur ose mbrapa vendit të faljes nëse lodhen.
- Mësoni ata të japin sadaka. Jepni sadaka në prezencë të tyre dhe tregoji atyre që ju jeni duke e bërë këtë sepse shpërblimet në Ramazan janë të shumëfishuara.
- Mësoni ata të lexojnë Kur’anin rregullisht dhe informoni ata që Pejgamberi paqja e Allahut goftë mbi të e ka bërë këtë gjë në Ramazan.
- Korrektoni ata nëse sillen në mënyrë të keqe ose shqiptojnë fjalë të papranueshme dhe përkujtoji ata që janë duke agjëruar ose që janë në Ramazan dhe që shpërblimi i tyre mund të zbeh shpërblimin e tyre.
- Zgjoni ata për Syfyr (edhe nëse nuk agjërojnë) dhe për namazin e Sabahut.
- Mësoni ata që të ushqejnë për iftar njerëzit që agjërojnë, dhe tregoni atyre reth shpërblimit për

këtë.

- Veshni dhe mbathni me rrobat më të mira, pastroni dhe merrni më vete në namazin e Bajramit. Mësoni ata se kjo është festa jonë dhe festimi i krishtlindjeve, ditës së falendërimeve dhe festat tjera nuk janë tonat, theksoni dallimin.

Dhe përkujtoni që Pejgamberi paqja e Allahut qoftë me të ka thënë:

“ Atij që i është dhënë përgjegjësia për rritjen e dy vajzave dhe edukimin e mire të tyre, ato do të jenë mburojë e tij nga Xhehenemi.”(Buhariu dhe Muslimi)